



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1701 Prot.

Tiranë, më 11.06.2024

VENDIM QARKULLUES

Nr. 91, datë 11.06.2024

“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN QARKULLUES NR. 35, DATË 25.03.2024 “PËR MIRATIMIN E SHPËRNDARJES SË KUOTAVE...” I NDRYSHUAR, TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e ndryshuar, Vendimit nr. 2, datë 26.01.2024 "Për miratimin e kuotave të pranimit, tarifave të konkurrimit dhe të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve...", Vendimit Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave..." i ndryshuar, të Senatit Akademik, si dhe propozimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresë nr. 1504/28 prot., datë 05.06.2024, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

- Hapjen e procedurave të pranimit në programet e specializimeve afatgjata në "Mjekësi Urgjence" dhe "Mjekësi Familje", për vitin akademik 2023-2024, në përputhje me pikën 1/a) të Vendimit Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave..." i ndryshuar, të Senatit Akademik, për kuotat e paplotësuara pas regjistrimit të specializantëve në fazën e parë, të mbuluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë:
 - Mjekësi Urgjence 13 kuota
 - Mjekësi Familje 9 kuota
- Për kuotat e paplotësuara për programet e specializimeve afatgjata në "Mjekësi Urgjence" dhe "Mjekësi Familje" sipas pikës 1, kandidatët do vlerësohen dhe renditen bazuar në notën mesatare të ponderuar të tyre.

3. Procesi i pranimeve për kuota e paplotësuara sipas këtij vendimi, kryhet në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi; Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e ndryshuar, si dhe të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Kandidatët e shpallur fitues në këto kuota lidhin kontratë me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj, detyrimet, penalitetet në rast mosrespektimi të tyre, është në kompetence të ministrisë përgjegjëse shëndetësinë, e cila ka dhe detyrimin e njoftimit të kandidatit lidhur me këtë aspekt.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe i përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e ndryshuar.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA

